

LIGJ
Nr. 9362, datë 24.3.2005

PËR SHËRBBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE
(Ndryshuar me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008; nr. 10 137, datë 11.5.2009)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të mbrojë bimët dhe produktet bimore nga parazitët;
- b) të parandalojë hyrjen dhe përhapjen e parazitëve në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) të mbrojë shëndetin e njerëzve, të kafshëve, si dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- ç) të garantojë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së bimëve.

Neni 2
Përkufizime

(Shtuar pikat 4/1 dhe 4/2 me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008)

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

- 1. “Inspektor” është inspektori i mbrojtjes së bimëve dhe karantinës.
- 2. “Parazit” është dëmtuesi, sëmundja dhe barërat e këqija, të dëmshme ose potencialisht të dëmshme për bimët dhe produktet bimore.
- 3. “Parazit karantinor” është një parazit i rrezikshëm, me ndikim të rëndësishëm ekonomik, që nuk është vërejtur ose është vërejtur në vendin tonë, por nuk është i përhapur gjerësisht.
- 4. “Produkt për mbrojtjen e bimëve (PMB)” është çdo produkt që përmban një ose më shumë lëndë vepruese, i cili përdoret:
 - a) për mbrojtjen e bimëve dhe të produkteve bimore nga parazitët ose për parandalimin e veprimt të tyre;
 - b) për të ndikuar në proceset jetësore të bimëve, por me veprim të ndryshëm nga plehërat kimike (për shembull, rregullatorët e rritjes);
 - c) për të shkatërruar bimët e padëshirueshme, pjesët bimore, si dhe për të mbajtur nën kontroll ose për të parandaluar rritjen e pjesëve bimore të padëshirueshme.
- 4.1 “PMB të rrezikshme” janë PMB-të e klasifikuara:

- a) eksplozive;
- b) oksiduese;
- c) ekstremisht të ndezshme;
- ç) lehtësisht të ndezshme;
- d) të ndezshme;
- dh) shumë helmuese;
- e) helmuese;
- ë) të dëmshme;
- f) gërryese;
- g) irritante;
- gj) të ndjeshme;
- h) kancerogjene;
- i) mutagjene;
- j) helmuese për riprodhimin;
- k) të rrezikshme për mjedisin.

4.2 “PMB me rrezik të lartë” janë PMB-të e klasifikuara:

- a) shumë helmuese (të klasës 1a ose T+);
- b) helmuese (të klasës 1b ose T);
- c) ekstremisht të ndezshme;
- ç) lehtësisht të ndezshme;
- d) të rrezikshme për mjedisin.

5. “Regjistrim” është miratimi për tregtim dhe përdorim të një PMB-je nga ministria që mbulon fushën e bujqësisë, bazuar në procedurën e vlerësimit të të dhënave shkencore të plota, të cilat vërtetojnë se PMB-ja është efektive për qëllimet e përdorimit dhe nuk përbën rrezik për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.

6. “Zonë” është territori ose pjesë e territorit që i përket një apo më shumë fshatrave, komunave, bashkive ose qarqeve.

7. “Mbetje të PMB-së” janë një ose më shumë lëndë vepruese të pranishme në bimë, në produkte me origjinë bimore, në produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, në mjedis, si rrjedhojë e përdorimit të PMB-së, duke përfshirë këtu edhe metabolitet dhe produktet që dalin nga shpërbërjet e tyre.

8. “Mbrotjtje e bimëve” është mbrotjtja e bimëve nga dëmtimet që shkaktohen prej parazitëve.

9. “Mbrotjtje e integruar” është përdorimi i kombinuar dhe i arsyeshëm i masave biologjike, bioteknologjike, kimike dhe teknikave të kultivimit, të cilat kufizojnë përdorimin e PMB-së në minimumin e nevojshëm, për të mbajtur popullatat e parazitëve në atë nivel, ku dëmi ekonomik është i pranueshëm.

10. “Certifikim i materialit shumëzues” është një procedurë ku bimët mëmë, candidate për dhënie e materialit shumëzues, kalojnë nëpër analiza dhe, kur është e nevojshme, në trajtim të veçantë, për të siguruar pastërtinë nga viruset dhe organizmat e tjerë të ngjashëm me ta.

11. “Praktika të mira të mbrotjtjes së bimëve” është tërësia e masave për luftimin e parazitëve me metodat kimike, duke respektuar kushtet në të cilat PMB-të janë regjistruar, si: respektimi i kufijve kritikë, zgjedhja e dozës dhe volumit, koha dhe numri i trajtimeve, mbrotjtja e entomofaunës natyrore dhe e mjedisit, si dhe kujdesi për shëndetin e përdoruesve dhe konsumatorëve.

12. “Objekte të tjera” janë çdo vend ruajtje, mjet transporti, konteiner, tokë, organizma të gjallë etj., që shërbejnë për strehimin ose përhapjen e parazitëve.

13. “Bimë” janë bimë të gjalla ose pjesë të tyre të gjalla, përfshirë farërat dhe germoplazmën.

14. “Prekje ose infeksion” është prania e parazitëve të gjallë në bimë, në produkte

bimore dhe në objekte të tjera.

15. “Inspektim” është shqyrtimi pamor i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, i kryer nga inspektori, për të përcaktuar nëse ato janë të infektuar ose të prekur me parazitë dhe nëse ato janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

16. “Karantinë bimore” është tërësia e masave parandaluese për hyrjen dhe/ose përhapjen e një paraziti karantinor.

17. “Produkt bimor” është material me origjinë bimore, i përpunuar ose jo, i cili mund të përbëjë rrezik për hyrjen dhe përhapjen e parazitëve dhe parazitëve karantinorë.

18. “Trajtim” është procedurë e autorizuar për ngordhjen, largimin ose bërjen të pashumëzueshëm të parazitëve.

19. “Certifikatë fitosanitare” është një dokument zyrtar i lëshuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve, i cili tregon se kushtet fitosanitare të bimëve, të produkteve bimore dhe të objekteve të tjera plotësojnë standardet e përcaktuara nga vendi importues.

20. “Masa të veçanta luftimi” është një tërësi masash karantinore, kimike agroteknike etj., që ndërmerren në rastet e shtimit dhe përhapjes masive të parazitëve dhe që synojnë në uljen e infeksionit në nivelin e dëmit ekonomik ose në çrrënjosjen e plotë të tyre.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE TË SHËRBITIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

Neni 3

Drejtimi dhe përbërja e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve

(Ndryshuar me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008)

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve përbëhet nga:

- a) Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve;
- b) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);
- c) Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB) në Universitetin Bujqësor, Tiranë, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 4

Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB)

1. **Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB)** është autoriteti kompetent që harton politikën e mbrojtjes së bimëve, si dhe organizon dhe ndjek zbatimin praktik e shkencor të këtij shërbimi nëpërmjet:

a) Inspektoratit të Mbrojtjes së Bimëve dhe të Karantinës në nivel qendror (ministria që mbulon fushën e bujqësisë) dhe rajonal (qarku), i cili kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, që rrjedhin prej tij;

b) Sekretarisë (Zyrës) së Regjistrimit të PMB-ve dhe Certifikimit të Materialit Shumëzues, e cila merret me procedurën e regjistrimit të PMB-ve, si dhe me procedurën e certifikimit të materialit shumëzues të specieve që shtohen në mënyrë vegjetative;

c) Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve (KSHRPMB), si organ kolegjal teknik, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të PMB-ve;

ç) laboratorëve rajonalë (të qarkut) të mbrojtjes së bimëve, të cilët merren me diagnostikimin dhe monitorimin e parazitëve dhe të parazitëve karantinorë, duke përcaktuar edhe masat e luftimit të tyre.

2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve është njëkohësisht kryeinspektor i këtij shërbimi.

Neni 5

Laboratorët e referencës dhe laboratorët e autorizuar të kontrollit

(Ndryshuar me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008)

1. Laboratorë reference janë:

1.1. Laboratorët e diagnostikimit të parazitëve pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve (DMB) në Universitetin Bujqësor, Tiranë, të cilët kanë për detyrë:

a) të monitorojnë parazitët karantinorë, të përcaktojnë statusin e tyre, mënyrat e kontrollit karantinor dhe të njoftojnë ministrinë që mbulon fushën e bujqësisë;

b) të bëjnë diagnostikimin dhe prognozë-sinjalizimin e parazitëve, duke përcaktuar edhe masat e luftimit të tyre;

c) të bëjnë provat biologjike-agronomike të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre.

1.2. Laboratori i analizave cilësore të PMB-ve, si dhe i mbetjeve të tyre pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i cili ka për detyrë:

a) të bëjë analizat fiziko-kimike të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;

b) të bëjë kontrollin cilësor të PMB-ve dhe të mbetjeve të tyre në bimët dhe produktet bimore.

2. Krahas detyrave të përcaktuara në pikat 1.1 e 1.2, laboratorët e referencës duhet, gjithashtu:

a) të bëjnë vlerësimin e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, nëse janë të pajisur për kryerjen e analizave për kontrollet zyrtare. Ky vlerësim shërben për autorizimin e tyre nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë;

b) të bashkërendojnë punën dhe të ofrojnë mbështetje, përfshirë trajnime dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë;

c) të organizojnë teste paralele të mostrave të standardizuara dhe të marrin pjesë në to në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të autorizuar të kontrollit;

ç) të garantojnë se laboratorët e autorizuar të kontrollit përdorin sistemin e tyre të brendshëm, në përputhje me standardet e kërkuara.

3. Për zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1.1 të këtij neni, ministria që mbulon fushën e bujqësisë lidh marrëveshje kontraktuale (kontratë) me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Laboratorët e autorizuar të kontrollit miratohen nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë, pas vlerësimit të kryer nga laboratorët e referencës. Si laboratorë të autorizuar të kontrollit shërbejnë laboratorët e mbrojtjes së bimëve pranë DRBUMK-së në qarqe, si dhe ato private, nëse plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

5. Kriteret që duhet të plotësojnë laboratorët e autorizuar të kontrollit për t'u miratuar, procedurat e miratimit dhe analizat që kryejnë përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

6. Tarifat e analizave që kryhen nga laboratorët e referencës dhe laboratorët e autorizuar të kontrollit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë dhe të Ministrit të Financave.

Neni 6

Bashkëpunimi

Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB) bashkëpunon dhe koordinon

punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit për përshtatjen e standardeve ndërkombëtare në Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve.

Neni 7

Bazueshmëria ligjore e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve

Organizimi dhe veprimtaria e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve rregullohet me këtë ligj, si dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

KREU III

LUFTIMI I PARAZITËVE

Neni 8

Masat paraprake të luftimit të parazitëve

Personat fizikë dhe juridikë që kultivojnë, prodhojnë, magazinojnë, përpunojnë dhe tregtojnë bimë dhe produkte bimore, janë të detyruar:

a) të marrin masa paraprake kundër parazitëve, si dhe të parandalojnë shumëzimin dhe përhapjen e tyre;

b) të vrojojnë bimësinë, tokën dhe produktet bimore për shfaqjen e parazitëve dhe t'i luftojnë ato në bazë të praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve dhe të kriterëve të mbrojtjes së integruar.

Neni 9

Fondet e veçanta për mbrojtjen e bimëve

1. Në buxhetin vjetor që miratohet për ministrinë që mbulon fushën e bujqësisë planifikohen fonde të veçanta për mbrojtjen nga parazitët të bimëve të kultivuara apo spontane.

2. Ministri që mbulon fushën e bujqësisë nxjerr urdhër për mbrojtjen nga parazitët, luftimi i të cilëve përballohet me këto fonde.

Neni 10

Masat e veçanta të luftimit të parazitëve

1. Në rastet emergjente të përhapjes dhe shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të luftimit, ministri që mbulon fushën e bujqësisë me urdhër përcakton masa të veçanta për luftimin e tyre, duke mobilizuar për këtë qëllim subjektet shtetërore dhe private, të cilët zotërojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe materiale.

2. Shpenzimet e luftimit në këto raste përballohen nga buxheti vjetor i ministrisë që mbulon fushën e bujqësisë.

Neni 11

Pastërtia e materialit shumëzues dhe mbjellës

1. Materialet bimore për shumëzim ose mbjellje lejohet të përdoren vetëm pasi t'i jenë nënshtruar inspektimit fitosanitar dhe të jenë pajisur me certifikatë fitosanitare.

2. Speciet drufrutore dhe hardhia, të cilat shtohen në mënyrë vegjetative, i nënshtrohen procedurës së certifikimit të materialit shumëzues për të siguruar pastërtinë nga viruset dhe organizma të tjerë të ngjashëm me to.

Neni 12
Udhëzime të Ministrit

Rregullat për luftimin e parazitëve përcaktohen me udhëzime të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

KREU IV
INSPEKTIMI KARANTINOR FITOSANITAR

Neni 13
Detyrimi për inspektim karantinor fitosanitar

Importi, eksporti dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera bëhet në pikat doganore të hyrjes, ku funksionon inspektimi karantinor fitosanitar dhe i nënshtrohen këtij inspektimi.

Neni 14
Veprimtari të ndaluara

Ndalohet:

1. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera të infektuara me parazitë karantinorë.
2. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, nëse ato nuk janë të pajisura me certifikatë fitosanitare.
3. Shumëzimi dhe kultivimi i bimëve të infektuara me parazitë karantinorë.

Neni 15
Bashkëpunimi për inspektimin karantinor fitosanitar

Për zbatimin e këtij ligji inspektori bashkëpunon, sipas marrëveshjeve të nënshkruara, me policinë kufitare, me punonjësit e doganës, me agjencitë rrugore, detare dhe hekurudhore, me kapiteneritë e porteve detare, me Inspektoratin Sanitar Shtetëror dhe me Inspektoratin Veterinar.

Ai është pjesë e grupit të praktikës doganore, që merr kontaktin e parë me mjetet që transportojnë bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera.

Neni 16
Njoftimi i organeve të Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve

Personat fizikë dhe juridikë, që merren me kultivimin, prodhimin dhe magazinimin e bimëve dhe të produkteve bimore, kur vërejnë ose dyshojnë për një parazit të pahasur më parë në një zonë ose për shtim masiv të një paraziti, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë organet e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve, si dhe të sigurojnë një mostër të tij.

Neni 17
Shpallja e zonës së prekur

Kur në një zonë shfaqet një parazit karantinor, ministri që mbulon fushën e bujqësisë e shpall me urdhër këtë zonë të prekur dhe përcakton masat për kufizimin e përhapjes së parazitit

karantinor deri në çrrënjosjen e tij.

Urdhri u bëhet i njohur organeve të qeverisjes vendore dhe prodhuesve, personave fizikë e juridikë që merren me kultivimin, prodhimin dhe magazinimin e bimëve dhe të produkteve bimore.

Neni 18 **Bllokimet**

Inspektori bllokon bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera kur vëren se ka shkelje të neneve 13, 14 dhe 16 të këtij ligji.

Menjëherë pas bllokimit, inspektori njofton me shkrim zotëruesin e tyre për kohën dhe arsyen e bllokimit.

Neni 19 **Shumëzimi i parazitëve për qëllime kërkimore**

Mbajtja dhe shumëzimi i parazitëve karantinorë për qëllime kërkimore dhe eksperimentale lejohet me urdhër të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë, kur ai gjykon se institucioni kërkimor zotëron mjetet e nevojshme që garantojnë me protokoll të veçantë mospërhapjen e parazitit karantinor.

Neni 20 **Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar**

Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

KREU V PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Neni 21 **Regjistrimi i PMB-ve** *(Shtuar paragraf me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008)*

Të gjitha PMB-të që hyjnë dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.

Në Republikën e Shqipërisë regjistrohen vetëm PMB-të, të cilat janë të regjistruara në vendet e Bashkimit European.

Neni 22 **Insitucionet vlerësuese të PMB-ve**

1. Institucionet për vlerësimin e PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit janë:
 - a) Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB) në Universitetin Bujqësor, Tiranë, i cili bën vlerësimin biologjik dhe agronomik;
 - b) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, i cili bën vlerësimin toksikologjik në kafshë;
 - c) Instituti i Shëndetit Publik, i cili bën vlerësimin toksikologjik në njerëz;
 - ç) Ministria e Mjedisit, e cila bën vlerësimin e ndikimit në mjedis.
2. Rregullat e regjistrimit dhe kriteret e vlerësimit të PMB-ve nga institucionet e

përmendura në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit.

Neni 23

Importimi dhe tregtimi

(Ndryshuar pikat 2, 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008; ndryshuar pika 2 dhe shfuqizuar pikat 3, 4 me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Lejohet importimi dhe tregtimi i PMB-ve të regjistruara.
2. Veprimtaritë e prodhimit, të tregtimit dhe importi i PMB-ve të rrezikshme dhe me rrezikshmëri të lartë, sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

Neni 24

Transporti, ruajtja dhe përdorimi

1. Transporti i PMB-ve kryhet me mjete të sigurta dhe të përshtatshme.
2. Ruajtja e PMB-ve bëhet në mjedise të caktuara për këtë qëllim, larg qendrave të banuara dhe atyre publike, për të mënjeluar ndikimet negative në mjedis.
3. PMB-të përdoren duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në dokumentin e regjistrimit.

Neni 25

Kualifikimi

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

1. Të drejtën e importimit dhe tregtimit të PMB-ve e kanë personat e diplomuar në fushën e agronomisë, ose që kanë të punësuar persona të diplomuar në fushën e agronomisë.
2. PMB-të e klasifikuara “PMB me rrezikshmëri dhe rrezik të lartë” përdoren vetëm nga personat e diplomuar në fushën e agronomisë ose që kanë të punësuar persona të diplomuar në fushën e agronomisë dhe nga ata, që janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë. PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme” përdoren nga persona të pajisur me dëshmi aftësie, ndërsa ato të klasifikuara “PMB-të e tjera” përdoren pa dëshmi.

Neni 26

Akte nënligjore për PMB-të

Rregullat për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB-ve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

KREU VI

KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 27

Kundërvajtje administrative

(Shtuar togfjalësh në pikën 8 dhe pika 11 me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008)

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji:

1. Moszbatimi nga personat fizikë e juridikë të kërkesave të nenit 8 të këtij ligji.
2. Moszbatimi nga subjektet shtetërore dhe private të kërkesave të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.
3. Përdorimi i materialeve bimore për shumëzim ose mbjellje pa iu nënshtruar inspektimit fitosanitar dhe pa u pajisur me certifikatë fitosanitare, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji.
4. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13 të këtij ligji.
5. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, si dhe shumëzimi dhe kultivimi i bimëve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14 të këtij ligji.
6. Mosrespektimi i detyrimeve për njoftimin e rasteve të shfaqjes së një paraziti të ri ose të shtimit masiv të tij, në kundërshtim me kërkesat e nenit 16 të këtij ligji.
7. Përdorimi në territorin e Republikës së Shqipërisë i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesën e nenit 21 të këtij ligji.
8. Importimi dhe tregtimi i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesat e neneve 23, pikat 2, 3 e 4 dhe 25 pika 1 të këtij ligji.
9. Transporti, ruajtja dhe përdorimi i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 të këtij ligji.
10. Përdorimi i PMB-ve të veçanta, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 25 të këtij ligji.
11. Importimi dhe tregtimi i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji.

Neni 28

Sanksione

(Shtuar pikat 5 e 6 me ligjin nr. 9908, datë 24.4.2008)

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 6 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 5 000 lekë.
2. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 10 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 10 000 lekë.
3. Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 9 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 15 000 lekë.
4. Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikat 7 e 8 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 20 000 lekë.
5. Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 11 të nenit 27 të këtij ligji jepet dënim me gjobë 50 000 lekë, si dhe detyrohet subjekti të kthejë PMB-të në vendin e origjinës së marrjes së tyre.
6. Në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikat 8 e 9 të nenit 27 të këtij ligji, subjektit i jepet dënim me gjobë 50 000 lekë dhe i hiqet e drejta e importimit ose e tregimit të PMB-ve.

Neni 29

Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 27, e ka inspektori.

2. Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim me shkrim te drejtuesi i strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve brenda 5 ditëve nga shpallja ose marrja e njoftimit të vendimit.

Drejtuesi i strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij.

3. Kundër vendimit të drejtuesit të strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve, ose kur ai nuk përgjigjet sipas afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor, ku është kryer kundërvajtja, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.

Neni 30

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i vendimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 19 dhe 20 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Akte nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 20, 22 pika 2 dhe 26 të këtij ligji.

Ngarkohet ministri që mbulon fushën e bujqësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 32

Shfuqizime

Ligji nr. 7662, datë 19.1.1993 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 4536, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**